

THE INFLUENCE OF BORROWED ANGLO-AMERICAN WORDS ON THE CONTEMPORARY GERMAN LANGUAGE

Shadan RAMADANI¹

¹ Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: shadan.ramadani@unite.edu.mk

Abstract

In contrast to the influences of the French and Italian language, the influence of the English language is a relatively new phenomenon. However, after World War 2, due to known circumstances, there has been a significant increase in the influence which has not been interrupted to this day. The theoretical part elaborates on the development of the German language and the concept of words that have been borrowed, as well as their integration into the language. The practical part analyses and specializes in some Anglo-Americanisms in the aspect of their use in newspapers in their respective time period. In this paper, the influence of borrowed words from the English language into the German will be shown through concrete examples. Despite being influenced a lot by English language, the German language still maintains its originality and nowadays is one of the most important languages in the world.

Keywords: German language, borrowed words, Anglo-Americanisms, concept of borrowing.

Përmbledhje

Në aspektin historik ndikimi i anglishtes në gjuhën gjermane është dukuri e re, për dallim nga frëngjishtja dhe italishtja. Megjithatë pas Luftës së Dytë Botërore ka një rritje të pandërprerë dhe intensitet më të theksuar për shkak të faktorëve dhe rrethanave që tashmë dihen. Në pjesën teorike shtjellohet zhvillimin i gjuhës gjermane, koncepti i huazimeve dhe mënyra sesi janë marrë ato. Në pjesën praktike veçohen dhe analizohen disa anglo-amerikanizma në aspektin e përdorimit të tyre në gazeta në një periudhë kohore. Me shembuj konkret pasqyrohet ndikimi i fjalëve të huazuara gjegjësisht fjalëve angleze në gjuhën gjermane. Gjuha gjermane si një gjuhë e rëndësishme në botë, pavarësisht se është shumë e ndikuar nga anglishtja, gjithmonë e ruan origjinalitetin e saj.

Fjalë kyçe: Gjuha gjermane, fjalë të huazuara, anglo-amerikanizma, koncepti i huazimeve.

Hyrje

Huazimet nga gjuha angleze mund të vërehen pothuajse në të gjitha gjuhët. Prandaj nuk mund të mohohet se anglishtja është gjuha më e përhapur në mbarë botën. Me huazim të fjalëve nënkuptohet procesi i huazimit, respektivisht, marrja e fjalëve të huaja dhe rezultati i këtij procesi. Me anglo-amerikanizëm nënkuptohet çdo dukuri leksikore që ndikohet nga anglishtja britanike ose amerikane dhe e njëjta mund të gjurmohet. Fjalët e huazuara nga anglishtja janë vërejtur që nga fundi i shekullit të XVIII, XIX dhe me të madhe në shekullin e XX, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, ku anglishtja u bë një gjuhë moderne, por edhe domosdoshmëri. Huazimet anglo-amerikane zënë një vend të rëndësishëm në leksikun gjerman. Ndonjëherë është e pamundur të përcaktohet saktësisht nëse fjala e huazuar është angleze britanike apo amerikane, prandaj këto fjalë quhen „anglo-amerikanizma“.

Në kohën e sotme vërehet po ashtu një tendencë për të përdorur fjalë angleze në vend të fjalëve gjermane dhe kjo ndodhë sepse anglishtja është bërë e pashmangshme. Andaj numri i huazimeve rritet ditë për ditë. Sigurisht, që studiues të ndryshëm, këtë proces e ndërlidhin ngushtë me rolin politik dhe ekonomik të SHBA-së dhe Britanisë së Madhe. Është një temë sa interesante, po aq befasuese, e cila ka shumë fjalë angleze në libra, gazeta, revista dhe sidomos në portale të ndryshme.

1. Koncepti i huazimeve dhe llojet e tyre

Gjuha gjermane, gjatë historisë së saj, shumë herë është pasuruar nga gjuhë të tjera dhe gjithashtu fjalori gjerman është përvetësuar edhe nga popuj të tjerë. Zakonisht huazohen fjalë dhe kuptime nga gjuhë të tjera, kurse rrallë herë huazohen frazeologjizma dhe konstruksione sintaksore dhe shumë më rrallë morfema fjalëformuese. Shumica e fjalëve të reja vijnë si huazime në një gjuhë tjetër. Ata ose përvetësohen drejtpërdrejtë në formën e huaj ose kopjohen dhe në mënyrë indirekte përshtaten në gjuhën përkatëse (A. Stedje, 1989, 23). Fjalët e huazuara nga anglishtja mund të ndahen në disa grupe. B. Carstensen bën dallimin midis huazimeve evidente (të jashtme) dhe latente (të brendshme) (B. Carstensen, 1979, 90).

Huazimi evident nënkupton marrjen dhe përshtatshmërinë e drejtpërdrejtë të termave anglezë në gjuhën gjermane, ku origjina në bazë të formës ose shqiptimit mbetet gati e pandryshueshme. Si huazime të brendshme karakterizohen huazimet që bazohen në një gjuhë të huaj dhe nuk e zbulojnë origjinën e tyre të huaj (S. Bohmann, 1996, 31). Sipas literaturës së trajtuar, me huazim kuptohet procesi i huazimit, gjegjësisht marrja e fjalëve të huaja dhe rezultati i këtij procesi - vetë fjalët e huazuara nga gjuha e huaj.

Në këtë punim do të trajtoj vetëm dy lloje të huazimit:

1. Huazimi i fjalëve dhe gjësendeve. Në këtë rast merren forma të fjalëve dhe gjësendeve të huaja nga një gjuhë, të cilat janë të reja ose të panjohura për gjuhën e cila huazon. Si për shembull mund të përmenden shumë fjalë latine në gjuhën gjermane që kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive dhe rrugëve: Mauer (mürus) / (murator); Straße (strata) / (rrugë); Fenster (fenstera) / (dritare), etj. Në shekullin e XX shumë anglo-amerikanizma u etabluan si huazime të zakonshme në gjermanisht.

2. Huazimi i fjalëve. Në këtë rast merren forma fjalësh të huaja, kuptimet e të cilëve tanimë janë shprehur në gjuhën e huazuar nëpërmjet fjalëve të tyre. Bëhet fjalë për forma me dy kuptime, të cilat herët a vonë do të dallohen për nga përmbajtja ose stili, si për shembull: Charme / Scharm për „Anmut“ / (hijeshmëri); Job - Arbeit / (punë).

1.1. Mënyra e marrjes së huazimeve

Gjuha gjermane posedon huazime të fjalëve që i ka përvetësuar si një substrat gjuhësor. Shumë emra vendesh, lumenjsh dhe fushash në Gjermaninë lindore janë me kuptim sllav, si për shembull: Dresden, Schwerin, Leipzig, Rostock, Brandenburg (<https://www.onomastik.com/on>, online më 22.05.2022). Rrugët e huazimeve të fjalëve të huaja ishin:

➤ Kontakti i drejtpërdrejtë ishte mënyra kryesore e marrjes së huazimeve në kohën e gjermanëve dhe në mesjetë nëpërmjet gojedhënieve ndërmjet folësve të gjuhëve të ndryshme. Kontaktet gjuhësore ishin të theksuara në zonat kufitare, nëpërmjet pushtimit të territoreve, nëpërmjet tregtisë dhe udhëtimeve.

➤ Më vonë huazimi i veprave letrare ndikoi më fortë nëpërmjet shkrimit. Sot njihet si mënyra kryesore që një fjalor i huaj të bartet në gjuhën gjermane.

➤ Rihuazimi prapa do të thotë kur një fjalë gjermane është marrë nga një gjuhë tjetër në periudhën më të hershme dhe më vonë përsëri kthehet në gjermanisht, si për shembull: Salon, Balkon / (dhomë ndenje, ballkon).

1.2. Anglo-amerikanizmat në gjermanishten bashkëkohore

Huazimet anglo-amerikane zënë një vend të rëndësishëm në leksikon gjerman. Megjithatë duhet theksuar se shpesh herë është e pamundur të përcaktohet saktësisht nëse fjala e huazuar është angleze britanike apo amerikane. Si rrjedhojë studiuesit i kanë futur në grupin e fjalëve që njihen sot si „anglo-amerikanizma“. Sipas B. Carstensen me anglo-amerikanizëm mund të kuptohet çdo fenomen leksikor, që mund të ndikohet nga anglishtja britanike ose amerikane.

Në fakt, fjalët e huazuara nga anglishtja u shfaqën në fund të shekullit të XVIII, XIX dhe sigurisht, me një ndikim të jashtëzakonshëm në shekullin e XX (veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore), ku anglishtja për shkaqe të ndryshme u favorizua tej mase. Fjalët e huazuara më së shumti prekin këto fusha:

➤ Fushën e teknologjisë dhe shkencës, si për shembull: Patent, patentieren, Tunnel, Radar, Ventilator, Pferdestärke / (patentë, patentoj, tunel, radar, ventilator, kuaj fuqi);

➤ Tregtisë dhe financave: Banknote, Export, Import, Partner, Prozent / (kartëmonedha, eksporti, importi, partneri, përqindja);

➤ Politikës dhe jetës shoqërore: Kongress, Koalition, Kolonisation, Opposition, Parlament, Parlamentarier, Klub, Meeting, Streik, Interview, Farmer, Reporter usw. / (kongresi, koalicioni, kolonizimi, opozita, parlamenti, parlamentarët, klubi, mbledhja, greva, intervista, fermeri, reporteri etj.);

➤ Artit dhe muzikës: Clown, Star, Jazz, Rock, Song usw. / (kloun, yll, xhaz, rok, këngë etj.)

➤ Sportit: Box, Boxer, Fußball, Hockey, Match, Sport, Start, Tennis, Tourist, Trainer, Training usw. / (boks, boksier, futboll, hokej, ndeshje, sport, nisje, tenis, turist, trajner, stërvitje etj.);

➤ Fushën e modës, amvisërisë, artin e kuzhinës: Bar, Flirt, Gentleman, Komfort, komfortabel, Plaid, Pullover, Smoking, Beefsteak, Brandy, Grog, Pudding, Punsch, Sandwich, Whisky, Picknick usw. / (bar, flirt, zotëri, rehati, rehat, karrocë, triko, smoking, biftek, raki, grog, puding, ponç, sandviç, uiski, piknik etj.).

Gjithashtu mund të vërehet një tendencë për të përdorur fjalë angleze në vend të fjalëve gjermane. Mendoj se kjo ndodhë sepse anglishtja është bërë edhe moderne. Andaj numri i fjalëve të huazuara rritet. Ky proces është i ndërlidhur ngushtë me rolin politik dhe ekonomik të SHBA-së dhe Britanisë së Madhe që kanë në botë. Çfarë problemi mund të ketë nëse përdoren shumë anglo-amerikanizma? A janë reale ose jo përpjekjet e gjuhës për tu zhvilluar? Në këtë drejtim ka shumë mendime. Mendoj se huazimet në çdo gjuhë janë zhvillim dhe prosperitet, njeriu mësohet gradualisht me ato. Por besoj se nuk duhet të ndrydhen veçoritë e të folurit të një gjuhë të caktuar. Ose nëse ka një fjalë të tillë në gjermanisht dhe mos të flitet një fjalë e tillë në anglisht.

2. Analizë e anglo-amerikanizmave të përzgjedhura

Siç e kam përmendur në pjesën teorike ndikimi i gjuhës angleze në gjuhën gjermane është më se e evidente. Unë kam vendosur që të veçoj dhe gjurmoj tre fjalë „die Kolonisation / (Kolonizimi), das Parlament / (Parlamenti) dhe das Meeting / (takimi)“ nga fusha e politikës në gazetën „Die Zeit“. E gjithë analiza e fjalëve realizohet me ndihmën e fjalorit elektronik në faqen e internetit dwds.de.

Në këtë analizë do të shqyrtohet periudha e 18 viteve të fundit respektivisht nga viti 2000 deri në vitin 2018. Vitet 2019 deri 2021 nuk janë të përfshira në korpusin e fjalorit elektronik DWDS, prandaj është marrë parasysh periudha deri në vitin 2018.

Die Kolonisation / (Kolonizimi)

Sipas fjalorit etimologjik (DWDS) fjala Kolonisation / (kolonizim) do të thotë: „Besiedlung, Erschließung erworbenen, eroberten, unzureichend genutzten Landes / (popullim-vendosje, zhvillim i përfitimeve, pushtim-vendbanim, shfrytëzim i pamjaftueshëm i vendit)“ dhe këtë kuptim kishte fjala rreth viteve 1800. Fjala rrjedh nga gjuha angleze (colonization) dhe me ndihmën e fjalorit (DWDS) mund të shihet se nuk e ka prejardhjen nga gjuha angleze, por nga gjuha latine. Kjo fjalë ka dy kuptime:

- Gewaltsame Eroberung und Aneignung wirtschaftlich rückständiger Gebiete durch fremde Staaten. Beispiel: die Kolonisation Afrikas durcheuropäische Staaten im 19. Jahrhundert. / (Pushtim dhe përvetësim i dhunshëm i zonave të prapambetura ekonomikisht nga shtetet e huaja. Shembull: Kolonizimi i Afrikës nga shtetet evropiane në shekullin e XIX);


- Erschließung und Besiedlung un bebauten Landes im Innern des eigenen Staatsgebietes. Beispiel: die innere Kolonisation. / (Zhvillim dhe vendosje në vendin e pa ndërtuar në brendinë e territorit të vet. Shembull: Kolonizimi i brendshëm.).

- Gjithashtu për fjalën „Kolonisation / (kolonizim)“ dallojmë disa grupe sinonimesh ose nëntërme:


- Grupe sinonimesh: Ansiedlung, Besiedelung, Besiedlung, Kolonisation, Kolonisierung, Landnahme / (ngulim, vendosje-popullim, kolonizim, marrja e tokës);

- Nëndefinicionë: Moorkolonisation, Moorkolonisierung / (kolonizim i moçaleve). (www.dwds.de).

Në periudhën e shqyrtuar fjala „Kolonisation / (kolonizim)“ është përmendur 43 herë në gazetën „Die Zeit“. Për të shpjeguar se sa herë në vit përmendej fjala e gjurmuar e kam hartuar në grafikë dhe rezultatet janë mjaft interesante.



E një rëndësie të veçantë është që të gjurmohet se sa herë është përdorur sinonimi „Besiedlung“ në të njëjtën periudhë kohore. Rezultati është mjaft interesant 319 herë dhe kjo shihet në grafikun e mëposhtëm.



Nga shembulli i fjalëve „Kolonisation / (kolonizim)“ dhe „Besiedlung / (vendosje-për banim)“ (A. Dhrimo, 2007, 162) shihet qartë se gjermanët preferojnë të përdorin ekuivalentin gjerman të fjalës.

Das Parlament / (Parlamenti)

Në bazë të fjalorit etimologjik (DWDS) fjala „Parlament“ do të thotë: „aus Wahlen hervorgegangene gesetzgebende Körperschaft eines demokratischen Staates, Abgeordnetenhaus / (organi legjislativ i zgjedhur nga elektorati i një shteti demokratik, dhoma e përfaqësuesve)“. Megjithëse fjala e ka prejardhjen nga frëngjishtja ajo është huazuar nga anglishtja dhe sipas fjalorit (DWDS) ka dy kuptime:


➤ „Vom Volk gewähltes, aus einer bestimmten Zahl von Abgeordneten gebildetes gesetzgebendes Organ eines Staates oder Gliedstaates, das meist das Budgetrecht hat, das Regierungsoberhaupt oder hohe Funktionsträger wählt sowie die Exekutive kontrolliert. Beispiel: Die Studierenden wählen für ihr Parlament ihre repräsentativen Abgeordneten, [...] / (Organi legjislativ i një shteti ose pjese të shtetit, i zgjedhur nga populli dhe i përbërë nga një numër i caktuar deputetësh, i cili zakonisht ka të drejtën e buxhetit, zgjedh kreun e qeverisë ose zyrtarët e lartë dhe kontrollon ekzekutivin. Shembull: Studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre për parlamentin e tyre,[...]).

➤ Gebäude, in dem ein Parlament seinen Sitz hat und üblicherweise tagt. Beispiel: Vor dem Parlament demonstrierten zeitgleich mit der Abstimmung [...] zehntausende Menschen gegen die Regierung. / (Ndërtesa në të cilën një parlament ka selinë dhe zakonisht mbledhet. Shembull: Në kohën e votimit demonstroi para parlamentit [...] dhjetëra mijëra njerëz.“ (www.dwds.de).

Edhe fjala „Parlament“ ka disa grupe sinonimesh: Abgeordnetenhaus, Nationalversammlung, Volksvertretung / (Dhoma e përfaqësuesve, Asambleja kombëtare, Përfaqësimi popullor).

Në periudhën e shqyrtuar të analizës fjala „Parlament“ është përmendur në gazetën „Die Zeit“ 46001 herë. Rezultatet e fituara dëshmojnë të kundërtën e analizës së fjalës „Kolonisation“. Në këtë rast fjala „Parlament“ është përdorur në mënyrë aktive viteve fundit dhe shihet se në vitin 2013 ka një rritje të jashtëzakonshme dhe është përdorur 7019 herë. Si shembull të barasvlershëm për fjalën „Parlament“ kam marr fjalën gjermane „Volksvertretung“.

Në periudhën e shqyrtuar kjo fjalë është trajtuar 573 herë. Krahasimi mund të shihet në shembullin e grafikut, ku linja me ngjyrë të kaltër përfaqëson fjalën „Parlament“ dhe ajo e portokalltë fjalën „Volksvertretung“. Për të ilustruar përdorimin e fjalëve të gjurmua gjatë periudhës së përcaktuar i kam prezantuar të dhënat e fituara në grafikë.




Në shembullin e këtyre dy fjalëve shihet qartë se në gazetën „Die Zeit“ është përdorur më shumë fjala Parlament. Kjo mund të ndërlidhet me faktin se përbën një prej fjalëve që është e zakonshme dhe e përdorshme në shumë vende të botës. Prandaj edhe gjermanët e përdorin këtë fjalë për të përcaktuar përfaqësimin popullor në vendet e huaja. Kurse në Gjermani përdoren fjalët Bundestag, Bundesrat etj.

Das Meeting / (Takimi)

Sipas të dhënave të fjalorit etimologjik kjo fjalë nënkupton: „Versammlung, Kundgebung, Sporttreffen / (mbledhje, tubim, takim sportiv)“. Fjala është huazuar nga anglishtja në gjermanisht dhe ka prejardhje angleze. Duke iu referuar fjalorit elektronik DWDS fjala ka këtë kuptim: „Zusammenkunft in offiziellem, großem Kreise, Treffen, Versammlung. / (Takim në rrethe zyrtare, mbledhje.)“. Në fjalorin DWDS për fjalën Meeting mund të gjenden dy grupe sinonimesh:

- „Konferenz, Kongress, Tagung. Meeting / (konferencë, kongres, mbledhje, takim);
- Besprechung, Konferenz, Sitzung. Treff, Treffen, Versammlung, Zusammenkunft / (bisedë, konferencë, takim, mbledhje)“. (www.dwds.de).

Në periudhën kohore mes vitit 2000 dhe 2018 fjala Meeting është përdorur 1592 herë. Për të krahasuar përdorimin e fjalës së huazuar kam marr fjalën gjermane „Tagung / (mbledhje-takim)“. Kjo fjalë është përdorur 2478 herë. Në grafik mund të shihen variabelët vjetore të përdorimit të fjalëve, ku linja e kaltër prezanton fjalën „Meeting“ dhe linja e portokalltë fjalën „Tagung“.



Nga shembulli mund të shihet se përdorimi i fjalës varet natyrisht nga situata politike. Në përgjithësi të dy fjalët pothuajse paralel kanë tendencën e ngritje-uljes. Shihet se fjala „Tagung“ në periudhën e përcaktuar në gazetën „Die Zeit“ përdoret për 886 herë më shumë se fjala e huazuar që do të thotë se gjermanët faktorizojnë fjalën vendore. Në fund të analizës mund të thuhet se fjala e huazuar që ndërlihet me faktin se është fjalë e zakonshme pothuajse në gjithë botën, si është rasti me fjalën „Parlament“, përdoret më shumë, kurse në dy shembujt tjerë përdoren fjalët vendore gjegjësisht fjalët gjermane „Besiedlung“ dhe „Tagung“ por dhe anasjelltas.

Për të shmangur ndikimin e gjuhës angleze, i cili është pa dyshim shumë i pranishëm në shumë sfera, duhet të tentohet të përdoren fjalët vendore respektivisht gjermane. Por ka edhe shumë fjalë të huazuara në gjuhën e përditshmërisë që nuk përdoren. Besoj se çdo gjë ka masën dhe synimin e saj, ndaj duhet menduar për përdorimin dhe ndikimin e fjalëve të huazuara. Nuk duhet harruar, se nëse përdoren shumë fjalë të huazuara ekziston mundësia që gjuha amtare të zbehet dhe ndoshta të rrezikohet.

3. Përfundim

Gjuha gjermane përgjatë historisë së saj është pasuruar nga gjuhë të tjera, por edhe thesari i gjermanishtes është përvetësuar nga popuj të tjerë. Globalizmi ka efektet e veta, sidomos në ndikimin e fjalëve të huaja në gjuhën amtare, ndërkohë që anglishtja, gjithnjë e më tepër është ndikuesja më e madhe në atë që mund ta quajmë gjuhë ndërkombëtare. E në këtë trend botëror dhe gjermanishtja nuk i ka “shpëtuar” huazimeve nga anglishtja. Në këtë studim janë analizuar disa fjalë të huazuara nga gjuha angleze në sektorin politik. Vlen të theksohet se shumë fjalë që konsiderohen si huazime nga gjuha angleze kanë prejardhje latine ose franceze.

Si përfundim mund të thuhet se ndikimi anglez në gjuhën gjermane është jashtëzakonisht i fortë. Besoj se duhet të mendohet për përdorimin e fjalëve të huaja në çdo gjuhë. Nuk mendoj se huazimi i fjalëve të huaja është diçka e keqe. Edhe pse njeriu përshtatet me përdorimin e huazimeve, megjithatë nuk duhet të rrezikohen veçoritë e të folurit të një gjuhe konkrete. Nëse ekziston fjala përkatëse në gjuhën gjermane atëherë e njëjta nuk duhet të zëvendësohet me fjalën angleze, të njëjtën praktikë duhet ta ndjekim edhe në gjuhën shqipe.

Referencat

- [1]. Bohmann, Stefanie (1996): Englische Elemente im Gegenwartsdeutsch der Werbebranche. Marburg.
- [2]. Cartensen, Broder (1979): Evidente und latente Einflüsse des Englischen auf das Deutsche. Në: Braun, Peter (Hrsg.): Fremdwortdiskussion. München.
- [3]. Dhrimo, Ali (2007): Fjalor Gjermanisht – Shqip. Tiranë.
- [4]. Stedje, Astrid (1989): Deutsche Sprache gestern und heute - Einführung in Sprachgeschichte und Sprachkunde. München.
- [5]. <http://dwds.de/> (vizituar më 27.05.2022)